



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT
(Përfundimtar)**

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

BASHKIA TIRANË

**NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.11
(NJËSIA BASHKIAKE NR. 11)**

TIRANË

Tiranë, Tetor 2015

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Bashkia Tiranë Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë (Njësia Bashkiake Nr.11, Tiranë)

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pikat 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, dhe planit vjetor të mbikëqyrjes, me vendimin nr. 67, datë 02.07.2015 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin, Njësia Bashkiake Nr. 11, Tiranë”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në Njësinë Bashkiake Nr. 11 (sot Njësia Administrative Nr.11), Tiranë.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial që kanë pësuar njësitë e qeverisjes vendore, në zbatim të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, njësitë bashkiake, janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, “Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”, pika 1 përcaktohet se, bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië, përfshirë edhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, “Transferimi i personelit”, parashikohet se, marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrië dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njësive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar, do t’i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Tiranë, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Mbikëqyrja u realizua sipas programit të mbikëqyrjes nr. 483/1 prot., datë 02.07.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 483/2 prot., datë 02.07.2015 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm, duke u përcaktuar një objekt i gjerë kontrolli, që përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin

civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, si dhe probleme të tjera të cilat kanë lindur gjatë zbatimit në praktikë të ligjit për nëpunësin civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i mbikëqyrjes, i përbërë nga inspektorët Gentiana Biku dhe Ilir Sauli, nën drejtimin teknik të Drejtores së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, Arbana Basha, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Njësinë Bashkiake Nr. 11, Tiranë, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit me shkresën nr. 483/3 prot., datë 23.09.2015, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse për projektraportin, rezulton se pranë Komisionerit është depozituar shkresa me nr. 933/1 prot., datë 06.10.2015, në përmbajtjen e së cilës janë pasqyruar disa sqarime në lidhje me gjetjet në projektraport, të cilat janë trajtuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në kapitujt përkatës. Kjo shkresë shoqërohej nga projektraporti, i pa nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë administrative, me pretendimin se nuk është organi kompetent që të shprehet në lidhje me ligjshmërinë ose jo të administrimit të shërbimit civil në ish Njësinë Bashkiake nr. 11, Tiranë, për shkak të riorganizimit teritorial të administratës vendore.

Ndërkohë, rezulton se projektraporti i është dërguar për njohje edhe Bashkisë Tiranë, sipas shkresës nr. 483/4 prot., datë 23.09.2015, të Komisionerit dhe nga ana e këtij institucioni nuk është paraqitur asnjë koment në lidhje me këtë akt.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Qëllimi i mbikëqyrjes:

- Mbikëqyrja, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para njësisë përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil dhe njësisë së burimeve njerëzore të subjektit të mbikëqyrur, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe në shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

2. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
 - Nëpunës të pranuar në shërbimin civil sipas procedurave konkurruese të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”;
 - Nëpunës, të pranuar në shërbimin civil si “punonjës ekzistues” sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”;
 - Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
 - Pozicione pune që përfshihen për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
 - Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
 - Rastet e refuzimit të statusit të nëpunësit civil.
3. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me planin vjetor të pranimit në shërbim civil.
5. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e komisionit të përhershëm të disiplinës, etj*).
6. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues*).
7. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
8. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
9. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes:

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me titullarin e institucionit, ku u bisedua dhe u ra dakord, për objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe dokumentacionin shkresor

që do të vihej në dispozicion të grupit të punës. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore u caktua si person kontakti me grupin e punës.

- Grupi i punës shqyrtoi pozicionet e shërbimit civil, sipas organigramës dhe organikës së hollësishme të institucionit.
- Verifikoi dosjet individuale të çdo nëpunësi të punësuar në vendet e shërbimit civil, librezat e punës, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- Kontrollon të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës (*nivelin e edukimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë etj.*), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- U verifikuan materialet që pasqyrojnë planin vjetor të pranimin në shërbimin civil, rastet e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, vlerësimet e punës dhe shënimet që shoqërojnë ato, etj.
- Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore iu kërkua që të paraqiste problemet me të cilat ajo ndeshet në praktikën e punës së përditshme, me qëllim që të asistohen teknikisht për zgjidhjen e drejtë të tyre.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneks nr. 1, Aneks nr. 2 dhe Aneks nr. 3*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

Përmbajtja e raportit:

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit

- Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në institucion, sipas strukturës aktuale.

Njësia administrative nr. 11, Tiranë, është pjesë e njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Tiranë, statusi i të cilës më parë përcaktohej në ligjin nr. 8654, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, i ndryshuar (tashmë i shfuqizuar).

Në nenin 13 të këtij ligji përcaktohej se: “*organet e njësisë bashkiake dhe administrata e tyre përfitojnë të drejta, si ato të bashkive të tjera të vendit, përsa i përket trajtimit të tyre*”. Gjithashtu, neni 5 dhe 6 i ligjit nr. 8654, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, përcaktonte bashkinë, si dhe njësitë bashkiake, si njësi të qeverisjes vendore. Për rrjedhojë, në fushën e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përfshihej edhe institucioni i Njësisë Bashkiake nr. 11, Tiranë, (sot Njësia Administrative nr. 11, Bashkia Tiranë) në përputhje me përcaktimet e nenit 2 të tij, ku parashikohet shprehimisht se “ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore...”.

Në Bashkinë e Tiranës kanë funksionuar gjithsej 11 njësi bashkiake, pjesë të qeverisjes vendore, të cilat sot janë njësi administrative. Administrata e tyre e ka ushtruar veprimtarinë mbi bazën e strukturës organizative, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë, sipas parashikimeve të nenit 32, shkronja “ç” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Struktura organizative dhe organigrama e Njesisë Bashkiake nr. 11, Tiranë, ka qenë e miratuar me vendimin nr. 18, datë 26.01.2001 të Këshillit Bashkiak Tiranë “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”, ndryshuar në vijimësi në rend kronologjik me vendimin nr. 10, datë 21.03.2005 “Mbi disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”; vendimin nr. 5, datë 05.02.2007 “Për caktimin e njësive bashkiake si agjent tatimor për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si dhe për një shtesë në numrin e punonjësve në strukturën organizative”; vendimin nr. 20, datë 30.04.2007 “Për kalimin e disa kompetencave njësive bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së Përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit” dhe vendimin nr. 23 datë 09.04.2013 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 17, datë 28.02.2013 “Mbi politikën e decentralizimit të disa kompetencave ligjore pranë organeve të Njësive Bashkiake të Tiranës, si dhe një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 20, datë 30.04.2007 “Për kalimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake dhe një ndryshim në numrin e punonjësve të Njësive Bashkiake dhe Drejtorisë së përgjithshme nr. 1 të punëtorëve të qytetit” (i ndryshuar) ”.

Në rastin konkret, sipas Vendimit nr. 10, datë 21.03.2005, të Këshillit Bashkiak Tiranë “Mbi disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 “Për miratimin e strukturës organizative të njësive bashkiake të Tiranës”, për Njësinë Bashkiake Nr. 11 (sot Njësia Administrative Nr. 11), janë miratuar gjithsej **21** pozicione pune dhe kësaj strukture i janë shtuar edhe **6** pozicione pune të miratuara me vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë, të përmendura më sipër, si dhe një pozicion pune që paguhet me fondet e veta.

Bazuar në këtë strukturë organizative, në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, (data 26.02.2014), Njësia Bashkiake Nr. 11 (sot Njësia Administrative Nr. 11, Bashkia Tiranë) ka pasur gjithsej **28** vende pune, të strukturuar në këtë mënyrë:

- numri i funksionarëve politikë ► **3** (kryetar + zv/kryetar + sekretar i këshillit bashkiak);
- numri i punonjësve administrativë ► **9** (1 sekretare e kryetarit + 1 punonjës biblioteke + 1 arshivist + 1 lulishtarë + 1 shofer + 2 roje + 2 pastrues);
- numri i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil ► **16**.

Në strukturën e Njesisë Administrative Nr. 11 përfshihen edhe **5** nëpunës të shërbimit të gjendjes civile (1 përgjegjës + 4 nëpunës), miratuar me Vendimin nr. 1299, datë 16.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna dhe në degët e qarqeve”.

Në kuptim të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, shërbimi i gjendjes civile, ushtrohet si funksion i deleguar i Këshillit të Ministrave në organet e qeverisjes vendore.

Mbështetur në aktet rregullative të përmendura më sipër, rezulton se institucioni i mbikëqyrur ka gjithsej **33** pozicione pune (**27** pozicione të miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak Tiranë + **1** pozicion pune që paguhet me fondet e veta + **5** pozicione pune të gjendjes civile), nga të cilat **16** pozicione janë pjesë e shërbimit civil (16 pozicione sipas strukturës + 5 pozicione të gjendjes civile).

Nisur nga kategoria dhe klasa e pozicioneve të punës sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, strukturimi i këtyre pozicioneve paraqitet në këtë mënyrë:

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së miratuar	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë dhe klasës
1.	Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues	Përgjegjës sektori	4 pozicione sipas strukturës 1 pozicion Zyra e Gjendjes Civile
2.	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialistë	12 pozicione sipas strukturës 4 pozicione Zyra e Gjendjes Civile
Pozicione të shërbimit civil gjithsej			21

Konkluzion: Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në këtë institucion, rezulton se struktura organizative për administratën e institucionit të mbikëqyrur është e organizuar duke u mbështetur në parimin e hierarkisë administrative. Në përmbajtjen e saj prezantohen niveli i funksionarëve politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë. Numri i punonjësve për çdo njësi organizative është brenda kufirit të lejuar dhe të miratuar.

II. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Njësia Administrative Nr. 11, është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse

veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, grupi i mbikëqyrjes ka verifikuar dhe analizuar:

- materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit e cila është aktualisht në fuqi;
- listëprezencën e muajit shkurt 2014 dhe listëprezencën e muajit qershor 2015;
- dokumentacionin që pasqyron punësimin në një pozicion të shërbimit civil;
- kohëzgjatjen e periudhës së punësimit;
- dokumentacionin që vërteton procedurën e marrjes në punë si dhe dokumentet personale të punonjësve.

Më poshtë po paraqesim mënyrën se si janë plotësuar 21 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion (16 pozicione sipas strukturës së miratuar + 5 pozicionet e gjendjes civile), duke u nisur nga procedura e aplikuar për plotësimin e tyre.

II/1) Nëpunës të pranuar në shërbimin civil, sipas procedurave konkurruese të ligjit nr.8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Subjekti i mbikëqyrur, është një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr.8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, tashmë i shfuqizuar, e për pasojë mënyra e vetme e plotësimit të pozicioneve të punës ka qenë nëpërmjet konkurrimit. Ndërkohë, nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të nëpunësve të punësuar në pozicione të shërbimit civil, rezulton se në këtë institucion, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (në datë 26.02.2014) në pozicionet pjesë e shërbimit civil, vetëm në 4 (katër) raste janë zbatuar kërkesat ligjore dhe punonjësit janë emëruar nëpërmjet konkurrimit, megjithëse paraprakisht kanë qenë të emëruar me kontratë në atë pozicion pune dhe bëhet fjalë për punonjësit :

- I. ***** – Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 20, datë 01.06.2001 “Për emërimin Përgjegjës Sektori”, e shoqëruar me kontratë pune pa afat, në pozicionin Përgjegjës Sektori i Burimeve Ekonomike në Njësinë Bashkiake nr. 11.

Marrëdhëniet financiare sipas kontratës dhe librezës së punës fillojnë në datë 01.06.2001. Me vendimin nr. 36, datë 02.06.2002 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil”, është konfirmuar në pozicionin “Përgjegjës Sektori i Burimeve Ekonomike”, pas plotësimit të periudhës së provës, Me aktin administrativ nr. 1867 prot., datë 18.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Burimeve Ekonomike”.

2. ***** – Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 18, datë 01.03.2001 “Emërimin Inspektor Finance dhe Kontrolli” e shoqëruar me kontratë pune pa afat në pozicionin “Inspektore Finance dhe Kontrolli”, në Njësinë Bashkiake nr. 11.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës fillojnë në datë 01.03.2001. Me vendimin nr.34, datë 01.03.2002 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil” është konfirmuar në pozicionin “Inspektore Finance dhe Kontrolli”, pas plotësimit të periudhës së provës. Me aktin administrativ nr. 1868 prot., datë 17.07.2014 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile, në pozicionin “Inspektor Finance dhe Kontrolli”.

3. ***** – Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës në këtë pozicion me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 33, datë 01.03.2002 “Emërimin e Specialistit Finance dhe Arke”, e shoqëruar me kontratë pune pa afat, është emëruar në pozicionin “Specialist Finance dhe Arke”.

Me vendimin nr. 46, datë 03.03.2003 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil” është konfirmuar në pozicionin “Specialist Finance dhe Arke”, pas plotësimit të periudhës së provës. Me aktin administrativ nr. 1869 prot., datë 17.07.2014 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil, në pozicionin “Inspektor Finance dhe Arke”.

4. ***** – Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 32, datë 15.02.2002 “Emërimin Inspektore e Punës Sociale”, e shoqëruar me kontratë pune pa afat në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale”, në Njësinë Bashkiake nr. 11.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës fillojnë në datë 15.02.2002. Me vendimin nr.47, datë 17.03.2003 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil”, është konfirmuar në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale (Administratore Shoqërore)”, pas plotësimit të periudhës së provës. Me aktin administrativ nr. 1861 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale (Administratore Shoqërore)”.

Konkluzion. Në këtë rast vlerësohet se Sektori i Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në momentin që i ka deklaruar këta punonjës me statusin e nëpunësit civil.

II/2) Nëpunës, të pranuar në shërbimin civil si “nëpunës ekzistues”, sipas përcaktimeve të nenit 27 të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”

Në institucionin e mbikëqyrur, rezulton se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (26.02.2014), konstatohen **2 (dy) raste**, si “nëpunës civil ekzistues”, në kuptim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, pasi hyrja në fuqi e këtij ligji e ka gjetur atë të punësuar në një pozicion të konsideruar pjesë e shërbimit civil. Për këta nëpunës është zbatuar neni 27, Kreu X, “Dispozita Kalimtare” i këtij ligji, sipas të cilit ata fillimisht janë konsideruar në periudhë prove, e në përfundim të saj janë konfirmuar si nëpunës civil dhe bëhet fjalë për nëpunësit si më poshtë:

1. ***** – Sipas librezës së punës, kjo nëpunëse në datën 16.06.1993, ka filluar punë si Administratore Shoqërore (emërtesa e këtij pozicioni në strukturën aktuale është ekuivalent me emërtesën Specialist i Përkrahjes Sociale). Më pas, me urdhrin e brendshëm të titullarit, nr. 3, datë 01.02.2001 “Për emërimin Inspektore e Punës Sociale”, e shoqëruar me kontratë pune pa afat, është emëruar në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale”, në këtë subjekt.

Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës fillojnë në datë 16.06.1993. Me vendimin nr.43, datë 03.01.2003 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil”, është konfirmuar në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale (Administratore Shoqërore)”. Më pas, me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 50, datë 16.04.2003 “Për emërimin Përgjegjës Zyre”, është emëruar në pozicionin, “Përgjegjëse Zyre e Punës Sociale”. Me aktin nr. 1859 prot., datë

17.07.2014 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile në pozicionin “Përgjegjëse Zyre e Punës Sociale”.

2. ***** – Sipas librezës së punës, kjo nëpunëse në datën 22.10.1997, ka filluar punë si Administratore Shoqërore (*emërtesa e këtij pozicioni në strukturën aktuale është ekuivalent me emërtesën Specialist i Përkrahjes Sociale*). Më pas me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 5, datë 01.02.2001 “Për emërimin Inspektore e Punës Sociale”, e shoqëruar me kontratë pune pa afat, është emëruar në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale”, në këtë subjekt. Me vendimin nr. 44, datë 03.01.2003, të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil” është konfirmuar në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale (Administratore Shoqërore)”. Me aktin nr. 1861 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile, në pozicionin “Inspektore e Punës Sociale (Administratore Shoqërore)”.

Konkluzion. Në këtë rast vlerësohet se Sektori i Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në momentin që i ka deklaruar këta punonjës me statusin e nëpunësit civil.

II/3) Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësi civil”, i ndryshuar

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), konstatohet se në këtë institucion, **5** (pesë) pozicione të shërbimit civil, janë plotësuar me akte emërimi të përkohshëm, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Megjithëse kjo dispozitë ligjore përcaktonte konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta punonjës, kanë vazhduar të rregullohen sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se në këtë institucion janë **5** (pesë) raste të tilla, kur punonjësit ekzistues, janë të punësuar në të njëjtin vend pune, pjesë e shërbimit civil, nëpërmjet kontratës së punës, për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, si më poshtë:

1. ***** – Marrëdhëniet e punës për këtë punonjës kanë filluar me urdhrin e brendshëm të titullarit, nr. 34, datë 17.09.2012, sipas kontratës nr. 1695 prot., datë 21.09.2012, në pozicionin e punës “Punonjës i Informacionit dhe Shërbimit Qytetar”, në këtë subjekt.

Marrëdhëniet financiare, sipas librezës së punës, për këtë punonjës fillojnë në datën 19.09.2012 dhe me aktin administrativ nr. 1857 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin “Inspektor Informacioni”.

2. ***** – Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës me vendimin e titullarit nr. 7, datë 22.02.2005, për emërimin si punonjës në gjendjen civile, shoqëruar me kontratën e punës dhe marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 22.02.2005, sipas librezës së punës. Më pas, rezulton se me urdhër të titullarit, nr. 408 prot., datë 25.04.2006, ka kaluar jurist pranë Njesisë Bashkiake nr. 11, pa procedurë konkurrimi, pozicion në të cilin edhe është konfirmuar si nëpunës civil. Me urdhrin e titullarit të institucionit, nr. 1496 prot., datë 30.11.2006, rezulton i komanduar në pozicionin e punës “Shef i Burimeve Njerëzore” dhe

më pas, me urdhrin nr. 23, datë 03.04.2007, ka kaluar “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”, përsëri pa procedurë konkurrimi. Me aktin administrativ nr.1856 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore”.

3. ***** – Ky punonjës ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 32, datë 14.05.2007, shoqëruar me kontratë pune pa afat në pozicionin “Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore”, pranë Njesisë Bashkiake nr. 11, Tiranë. Megjithëse pa procedura konkurimi, në kundërshtim me ligjin, ky punonjës, me vendimin nr. 20, datë 22.05.2008 të titullarit “Për konfirmimin si nëpunës civil”, është konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore”. Me aktin administrativ nr. 1870 prot., datë 17.07.2014 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunës civil në pozicionin “Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore”.
4. ***** – Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm nr. 770 prot., datë 09.06.2008, të titullarit të institucionit, shoqëruar me kontratë pune në pozicionin “Inspektor të Infrastrukturës Publike”, pranë Njesisë Bashkiake nr. 11, Tiranë. Më pas, me urdhrin nr. 1439 prot., datë 05.10.2009, të titullarit, ka kaluar në pozicionin “Juriste” pranë kësaj njësie, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit. Me aktin nr. 1858 prot., datë 17.07.2014, të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile, në pozicionin “Juriste në Sektorin e Burimeve Njerëzore”.
5. ***** – Kjo punonjëse ka filluar marrëdhëniet e punës me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 2044 prot., datë 02.11.2012, shoqëruar me kontratë pune në pozicionin “Inspektor Mjedisi dhe Ambjenti”, pranë Njesisë Bashkiake nr. 11, pa procedurë konkurrimi. Marrëdhëniet financiare sipas librezës së punës fillojnë në datë 05.11.2012. Me aktin nr. 1872 prot., datë 17.07.2014 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile, në pozicionin “Inspektor Mjedisi dhe Ambjenti në Sektorin e Urbanistikës dhe Infrastrukturës”.

Konkluzion. Në këtë rast vlerësohet se Sektori i Burimeve Njerëzore, ka vepruar në përputhje me nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në momentin që i ka deklaruar këta punonjës me statusin e nëpunësit civil.

II/4) Raste të zbatimit të gabuar të ligjit, në lidhje me deklarin e statusit të punësimit

Nga analiza e materialeve të verifikuara, konstatohet se në **1** (një) rast, njësia e burimeve njerëzore, në procedurat e ndjekura për deklarin e statusit të punësimit, nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht bëhet fjalë për punonjësën:

- ***** – në pozicionin e punës “Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen individuale të punonjësës, u konstatua se, me vendimin nr. 15, datë 12.04.2010, të titullarit të institucionit, shoqëruar me kontratë pune, ajo është emëruar në pozicionin “Sekretare e Kryetarit”, pranë Njesisë Bashkiake nr. 11, Tiranë. Më pas, rezulton se titullari i institucionit ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 5, datë 30.04.2013, nëpërmjet të cilit kjo punonjëse ka kaluar në pozicionin “Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve”, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit.

Konstatohet se me aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 1509 prot., datë 17.04.2015 të njësisë përgjegjëse, është deklaruar si nëpunëse civile, në pozicionin “*Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve*”.

Nisur nga sa parashtruar më sipër, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kjo nëpunëse ka qenë e punësuar në pozicionin e punës “*Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve*”, pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, kjo punonjëse ka filluar punë në pozicionin “*Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve*, në datën 30.04.2013 dhe rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit në këtë pozicion, të jetë më pak se 1 vit.

Në këto rrethana, sipas të dhënave të administruara, kjo punonjëse nuk mund të deklarohet me statusin e nëpunësit civil, pasi kishte me pak se 1 vit në marrëdhënie pune me pozicionin në fjalë, dhe për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet si nëpunëse civile në periudhë provë. Në këtë rast, periudha e provës duhet të llogaritet duke nisur nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (data 26.02.2014).

Konkluzion: Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, me qëllim që të rregullohet situata në këtë rast, Komisioneri rekomandon se, njësia përgjegjëse duhet të kryejë veprimet sipas këtij rendi:

- Të ndryshojë aktin nr. 1509 prot., datë 17.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen ******, në pozicionin “*Specialiste për Mbrojtjen e Fëmijëve*”, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë provë*”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike.
- Momenti i vlerësimit të punës, për punonjësen që ka qenë në marrëdhënie pune me akte emërimi të përkohshëm, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet të përkojë me përfundimin e periudhës së provës, që në këto raste fillon në datën 26.02.2014.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), në rastet kur nuk është materializuar në certifikatën e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
- Të nxjerrë për nëpunësen vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

II/5) Pozicione pune që përfshihen për herë të parë në fushën e veprimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ashtu si analizuam në hyrje të këtij materiali, pjesë e strukturës së Njesisë Administrative Nr. 11, është edhe Zyra e Gjendjes Civile, e cila përfshihet për herë të parë në skemën e shërbimit civil.

Marrëdhëniet e punës për punonjësit e Zyrës së Gjendjes Civile, në Njësitë Bashkiake, deri në datën 26.02.2014, janë rregulluar sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përfshin në skemën e shërbimit civil edhe Zyrat e Gjendjes Civile, në Njësitë Administrative, pasi në nenin 2 të tij, parashikohet në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të ligjit përfshin çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Më tej, në nenin 65 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile”, përcaktohet se, rekrutimi i nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile bëhet mbi bazën e kriterëve dhe procedurave konkurruese, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, që është organi më i lartë i shërbimit të gjendjes civile dhe një institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Pra, duke pasur parasysh faktin që, emërimi i punonjësve të shërbimit të gjendjes civile, kryhet mbi bazën e një procedure konkurruese të ngjashme me ato të përcaktuara nga ligji nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe përfshirjen e këtyre pozicioneve në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil.

Zyra e Gjendjes Civile, në institucionin e mbikëqyrur, përbëhet nga **5** pozicione pune ku janë punësuar punonjësit si më poshtë:

1. ***** – në pozicionin e punës *Përgjegjëse e Zyrës së Gjendjes Civile*, emëruar në këtë pozicion me urdhrin nr. 26, datë 17.09.2001 të drejtuesit të institucionit; konfirmuar si nëpunës civil me vendimin nr. 38, datë 17.09.2002 të drejtuesit të institucionit; akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 1862 prot., datë 17.07.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Përgjegjëse e Zyrës së Gjendjes Civile në Njësinë Bashkiake nr. 11*).
2. ***** – në pozicionin e punës *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile*, emëruar në këtë pozicion me urdhrin nr. 27, datë 17.09.2001 të drejtuesit të institucionit; konfirmuar si nëpunës civil me vendimin nr. 39, datë 17.09.2002 të drejtuesit të institucionit; akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 1863 prot., datë 17.07.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile në Njësinë Bashkiake nr. 11*.
3. ***** – në pozicionin e punës *Punonjës i Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile*, emëruar në këtë pozicion me urdhrin nr. 408, datë 25.04.2006 të drejtuesit të institucionit dhe në zbatim të shkresës nr. 5074 prot., datë 13.07.2009 të Ministrisë së Brendshme; konfirmuar si nëpunës civil me vendimin nr. 35, datë 30.11.2010 të drejtuesit të institucionit; akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 1866 prot., datë 17.07.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile në Njësinë Bashkiake nr. 11*.
4. ***** – në pozicionin e punës *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile*, emëruar në këtë pozicion me urdhrin nr. 32, datë 14.12.2009 të drejtuesit të institucionit dhe në zbatim të shkresës nr. 6192/2 prot., datë 25.10.2010 të Ministrisë së Brendshme; akti i deklaramit të statusit të punësimit nr. 1864 prot., datë 18.07.2014 si nëpunës civil në

pozicionin *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile në Njësinë Bashkiake nr. 11*.

5. ***** – në pozicionin e punës *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile*, emëruar në këtë pozicion me vendimin nr. 23, datë 14.04.2005 të drejtuesit të institucionit dhe në zbatim të shkresës nr. 6192/2 prot., datë 25.10.2010 të Ministrisë së Brendshme; akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 1865 prot., datë 17.07.2014 si nëpunës civil në pozicionin *Punonjëse e Gjendjes Civile në Zyrën e Gjendjes Civile në Njësinë Bashkiake nr. 11*.

Për të gjithë këta punonjës, që momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i ka gjetur si nëpunës të Zyrës së Gjendjes Civile, në pozicionet përkatëse të punës, njësia përgjegjëse, ka verifikuar plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të Kreut III, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë, që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, e për pasojë edhe është finalizuar procesi me aktin e deklarimit të statusit të punësimit, sipas ligjit për nëpunësin civil.

Ndërkohë, për pozicionet e punës së Zyrës së Gjendjes Civile, ashtu si dhe për pozicionet e tjera të shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk ka hartuar përshtimet e reja të punës, sipas formatit standard të miratuar, siç përcaktohet në aktin përkatës nënligjor.

Në këto rrethana Komisioneri rekomandon se, duhet të merren masat, për të hartuar përshtimet e punës, duke kujdesur që të gjitha veprimet në këtë rast të jenë në koherencë të plotë me riorganizimin e këtij subjekti, në kushtet e reformës territoriale dhe të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë proces.

II/6) Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë emëruar me akte emërimi të përkohshme, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, konstatohet se, në këtë institucion, në 1 (një) rast, konstatohet se në një në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, është emëruar punonjës me emërim të përkohshëm dhe konkretisht:

1. ***** Me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 1012 prot., datë 07.04.2014, shoqëruar me kontratën e punës nr. 1012/2 prot., datë 07.04.2014, është emëruar në pozicionin e punës “*Shefe e Urbanistikës - Infrastrukturës*”.

Komisioneri konstaton se, akti i emërimit për këtë rast, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt ligjore, si konkurrimi, lëvizja paralele, apo ngritja në detyrë. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Për këtë arsye, Komisioneri rekomandon se, njësia përgjegjëse për rregullimin e ligjshmërisë në shërbim civil në këtë rast, duhet të revokojë aktin e emërimit për punonjësen ***** në pozicionin e punës “*Shefe e Urbanistikës - Infrastrukturës*” dhe për plotësimin e pozicionit të ndiqen procedurat ligjore, që rregullojnë institutin e rekrutimit.

II/7) Rastet e refuzimit të statusit të nëpunësit civil.

Nga analiza e materialeve të verifikuara në këtë institucion, konstatohet se nuk ka raste të refuzimit të deklaramit të statusit të punësimit.

II/8) Pozicione pune që nuk janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil

Nga verifikimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit që na u vu në dispozicion, e në veçanti, nga trajtimi i akteve që materializojnë strukturën dhe organikën e subjektit të mbikëqyrur, Komisioneri konstaton se, në procedurat e deklaramit të statusit të punësimit **3** (tre) pozicione pune nuk janë trajtuar si pjesë e shërbimit civil. Këto pozicione janë:

- **1** pozicion pune me emërtesën “*Specialist për Tregjet*”,
- **1** pozicion pune me emërtesën “*Specialist i Infrastrukturës (Topograf)*”,
- **1** pozicion pune me emërtesën “*Arkivist-Protokollist*”.

Nga institucioni u pretendua se pozicionet e punës “*Specialist për Tregjet*”, janë funksione të cilat i janë deleguar njësisve bashkiake nga Bashkia e Tiranës, me vendim të këshillit bashkiak dhe si të tilla, këto pozicione nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Nga verifikimet rezulton se, Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës, me Vendimin nr. 51, datë 03.11.2004 “*Për delegimin e disa kompetencave Njësive Bashkiake të qytetit të Tiranës*”, ka miratuar delegimin nga Bashkia e Tiranës në Njësitë Bashkiake, të kompetencave që lidhen me administrimin e Tregjeve Publike dhe Bibliotekave në qytetin e Tiranës.

Në zbatim të këtij vendimi, pozicioni “*Specialist për Tregjet*” është përfshirë në strukturën e Njesisë Bashkiake Nr. 11, Tiranë, në vitin 2005, sipas strukturës së miratuar me Vendimin nr. 10, datë 21.03.2005 të Këshillit Bashkiak të Bashkisë së Tiranës “*Mbi disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 26.01.2001 “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Bashkiake të Tiranës”*”.

Sipas këtij vendimi dhe Tabelës 1 bashkëlidhur tij, strukturës ekzistuese të Njesisë Bashkiake Nr.11, i shtohen **1** vend pune për pozicionin “*Specialist për Tregjet*” dhe **1** vend pune për pozicionin “*Inspektor Shërbimesh*”. Lidhur me këtë, Këshilli Bashkiak, me Vendimin nr. 10, datë 20.04.2006, ka miratuar këto propozime për shtesë në strukturën organike të Njesisë Bashkiake.

Lidhur me pozicionin e punës “*Arkivist-Protokollist*” duhet të sjellim në vëmendjen e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore se, së pari, pozicioni i punës “*Arkivist-Protokollist*” është pjesë e organikës së institucionit dhe është i identifikuar si pozicion pune që ka përgjegjësi, në mënyrë specifike vetëm për administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të subjektit të kontrolluar. Pra, fokusi i punës së mbajtësit të këtij pozicioni është ruajtja dhe mirëmbajtja e fondit të dokumenteve që krijohen, apo hyjnë në institucion dhe nuk ka përgjegjësi për të kryer funksione të tjera;

së dyti, brenda strukturës së institucionit, ky pozicion pune është i vendosur në Sektorin e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe raporton tek përgjegjësi i sektorit dhe

së treti, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” në pikën 9, shkronjat “a” dhe “b”, dhe në pikën 12 kreu III, përcakton:

“9. Pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive klasifikohen sipas natyrës së pozicionit në:

- a) grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe;
- b) grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.

10.

11.

12. Grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në lidhjen 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.”

Më tej, Lidhja nr. 3, “Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/ sipas profesioneve të punës”, në kolonën e parë ka renditur grupet e specialistëve të administratës publike të përfshirë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil sipas profesioneve. (Kjo lidhje është e ndërtuar me 6 kolona). Në ndarjen me numër rendor 26, në kolonën e dytë dhe të pestë përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e pozicionit të punës specialist i arkivave/arkivist, në njësitë vendore në përputhje me legjislacionin përkatës të arkivave.

Konkluzion: Sa më sipër, njësia përgjegjëse, në lidhje me punonjësit që kanë punuar në pozicionet e punës “Specialist për Tregjet”, “Specialist Infrastrukturës (Topograf)” dhe “Arkivist-Protokollist”, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, duhet të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të deklarojë statusin e punësimit për secilin prej tyre.

Në rastet e refuzimit të statusit, për këto pozicione, si dhe në koherencë me ndryshimet organizative të bashkisë, njësia përgjegjëse duhet të shpallë pozicionin si të lirë dhe të bëjë plotësimin e tij në bazë të nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet një procedure të rregullt ligjore, si konkurrimi, lëvizja paralele, apo ngritja në detyrë.

III. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.

Një institut shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicione pjesë e shërbimit civil.

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, e ngarkoi institucionin e mbikëqyrur, me detyrën e hartimit të përshkrimeve të pozicioneve të punës, brenda një afati të përcaktuar, që ishte data 1 korrik 2014.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes të kryer në këtë institucion, Komisioneri konstaton se, nuk është respektuar afati ligjor dhe për më tepër, ende kjo detyrë nuk është realizuar.

Ndërkohë, rezulton se në Rregulloren e Brendshme të institucionit (“Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Njesisë Bashkiake Nr. 11”, e miratuar nga Këshilli i Njesisë Bashkiake nr. 11 me vendimin nr. 29, datë 15.04.2010), janë evidentuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë secili pozicion pune, sipas strukturës dhe organikës së institucionit.

Konkluzion: Në këto rrethana, rekomandohet njësia përgjegjëse që në koherencë me ndryshimet organizative të institucionit, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe Lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

IV. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me planin vjetor të pranimit në shërbim civil

Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se në këtë institucion nuk ka qenë i miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil. Në këto rrethana, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Tiranë, që të përfshijë në planin vjetor të saj edhe nevojat e njësisë administrative, subjekt mbikëqyrjeje, sipas kërkesave të nenit 18 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

V. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e komisionit të përhershëm të disiplinës, etj).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që na është vënë në dispozicion, lidhur me zbatimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë, u konstatua se në Njësinë Administrative Nr. 11, Tiranë, që nga viti 2013, e deri në momentin e realizimit të kësaj mbikëqyrjeje, nuk ka realizuar procedura për dhënien e masave disiplinore për nëpunësit civil.

VI. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014 për nëpunësit civil në këtë subjekt dhe njëkohësisht, se si është materializuar procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur nëpunësve kompetentë të këtij procesi, gjatë vitit të vlerësimit (zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues).

Grupi i punës verifikoi aktet administrative që kanë lidhje me këtë proces, për të vërtetuar nëse procesi i vlerësimit është kryer sipas përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” dhe konstatoi se, nuk janë bërë vlerësimet e rezultateve në punë sipas përcaktimeve të mësipërme.

Konkluzion: Në këto rrethana, njësia përgjegjëse duhet të sistemojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve të njësisë administrative nr.11, Bashkia Tiranë, për vitin 2014, duke vepruar si më poshtë:

- Të hartojë dhe të plotësojë formularët e vlerësimit të punës sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.
- Të nënshkruhen formularët e vlerësimit të punës nga personat përgjegjës dhe të depozitohen pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tiranë, si pjesë e dosjes personale të çdo nëpunësi civil.

VII. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit dhe aspekte të tjera në lidhje me këto procese.

Komisioneri verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe

sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjeve 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur këtij akti nënligjor që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*) dhe dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar për secilin nëpunës në anekset që i bashkëlidhen projektraportit, si pjesë e tij.

Më qëllim që në të ardhmen, procesi i administrimit të shërbimit civil të zhvillohet duke u materializuar me aktet përkatëse të administruara në dosjen e personelit, Komisioneri rekomandon që njësia e personelit të plotësojë dosjen e personelit duke pasur parasysh këto aspekte:

Përshkrimet e punës, dhe vlerësimet e punës të plotësuara në mënyrën e duhur dhe të nënshkruara nga nëpunësit/strukturat kompetente (*të hartuara, të nënshkruara dhe të formalizuara si çdo dokument tjetër zyrtar*), të administrohen në dosjen e individuale të nëpunësit civil.

Kjo për faktin se, përshkrimi i punës dhe vlerësimi i punës në rubrikat apo në ndarjet e tyre përkatëse, trajtojnë elementë të ndryshëm që kanë lidhje me gjithë dinamikën e karrierës së nëpunësit civil, ndër të cilat, kërkesat e posaçme të vendit të punës, nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për pozicionin e punës etj.

Konkluzion: Në lidhje me këtë institut, vlerësohet se dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore.

Nga ana tjetër, duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjen e personelit me dokumentet e evidentuara në aneksin përkatës, si të munguara, bashkëngjitur raportit, si dhe në përputhje me rekomandimet e paraqitura në raport.

VIII. Probleme të ndryshme lidhur me administrimin e burimeve njerëzore gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Administrimi i shërbimit civil, është një proces i rëndësishëm, i cili duhet të realizohet duke u drejtuar nga ligji, për të siguruar respektimin e parimeve të këtij procesi, që synojnë në vendosjen e palëve përballë shanseve të barabarta, zhvillimin e një karriere të bazuar në meritë, mos diskriminimin e palëve në proceset e administrimit, profesionalizmit të administratës, sigurimin e transparencës dhe paanësisë politike, si dhe të garantohet qëndrueshmëria në detyrë e nëpunësit civil dhe vazhdimësia në shërbimin civil.

Ndonëse efektet e ligjit për nëpunësin civil kanë filluar prej më shumë se një viti, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Njësisë Administrative Nr. 11, konstatohet një harmonizim vetëm pjesërisht me parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Pavarësisht faktit që korniza ligjore e cila rregullon fushën e shërbimit civil është plotësuar, duke përcaktuar me qartësi kushtet dhe hapat që duhet të ndërmarrin institucionet shtetërore që i nënshtrohen fushës së zbatimit të tij, përsëri vërehet zbatim jo i plotë i ligjit nga ana e institucionit të mbikëqyrur.

Në këtë kontekst konstatohet se, ndonëse janë bërë përpjekje për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, në disa raste nuk janë respektuar e përmbushur plotësisht normat dhe standardet e përcaktuara në ligj. Konstatohet se në disa raste, nga ana e institucionit është bërë një interpretim jo i saktë i ligjit nr. 152/2103, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Ashtu si u parashtrua më sipër, ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përcakton procedurën e konkurrimit si mënyrën e vetme të pranimit në shërbimin civil në pozicionet e nivelit ekzekutiv, por edhe në rastet e ngritjes në detyrë.

Në këto kushte, ligji e ndalon emërimin me akte emërimi pa zhvilluar konkurrimin, apo emërimin duke aplikuar kontrata të përkohshme punësimi, sipas Kodit të Punës, duke e përcaktuar shprehimisht se këto akte, janë absolutisht të pavlefshme, ç`ka nuk është mbajtur parasysh në të gjitha rastet nga njësia përgjegjëse e ish Njesisë Bashkiake nr.11, Tiranë.

Njësia përgjegjëse e njësive të qeverisjes vendore duhet të përfaqësojë një nivel më të lartë ndërgjegjësimit dhe përgjegjësie, jo vetëm në planifikimin e vendeve të lira në shërbimin civil, por edhe në rritjen e nivelit të bashkëpunimit me institucione të tjera, që janë pjesë e skemës së administrimit të shërbimit civil dhe që luajnë një rol të rëndësishëm në administrimin e shërbimit civil, si Departamenti i Administratës Publike dhe Shkolla e Administratës Publike (ASPA).

Një bashkëpunim më i ngushtë i njësisë përgjegjëse, kërkohet edhe me nëpunësit civil të institucionit, me qëllim identifikimin e nevojave të tyre për trajnim, duke shfrytëzuar dhe rrugët e bashkëpunimit me Shkollën e Administratës Publike, apo edhe mundësi të tjera, të cilat sjellin ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të nëpunësve të institucionit në të gjithë drejtimit e kërkuar nga ligji.

Nisur nga rrethanat e reja në të cilat do të vijojë administrimi i shërbimit civil në institucionet e administratës vendore, në kuadër të riorganizimit të pushtetit vendor, del si domosdoshmëri që subjekti të ketë identifikuar saktë nëpunësit, të cilët përfitojnë nga ligji 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi ata gëzojnë të gjitha të drejtat e sanksionuara në këtë ligj, si dhe të ketë të administruar në dosjen personale të nëpunësit civil, të gjithë dokumentacionin që materializon karrierën e tij në shërbimin civil.

➤ Vendimet gjyqësore

Në lidhje me këtë aspekt të mbikëqyrjes, rezulton se gjatë verifikimit të praktikave dokumentare lidhur me administrimin e shërbimit civil, u konstatua se, në këtë institucion aktualisht nuk evidentohen çështje gjyqësore, që kanë lidhje me marrëdhëniet në shërbimin civil.

➤ Personel i miratuar nga të ardhurat e njësisë

Nga verifikimi i dokumentacionit u konstatua se 1 (një) person, paguhej nga të ardhurat e njësisë dhe është emëruar mbi numrin që parashikon struktura e miratuar nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës, duke u mbështetur në Vendimin nr. 7 datë 24.02.2006 të Këshillit Bashkiak Tiranë “Mbi numrin e punonjësve të njësive bashkiake të Tiranës”, që lejonte subjektin të shtonte pozicione pune në strukturë, në varësi të buxhetit të njësitë bashkiake. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin,

Me urdhrin e brendshëm të titullarit nr. 25 prot., datë 10.04.2007, shoqëruar me kontratë pune, është emëruar në pozicionin e punës “*Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore*”. Me vendimin nr. 18, datë 17.04.2008, të titullarit “*Për konfirmimin si nëpunës civil*”, është konfirmuar në pozicionin e punës “*Inspektor Taksash dhe Tarifash Vendore*”.

Pra në këtë rast, megjithëse ky pozicion është miratuar në mënyrë të përkohshme nga njësi bashkiake, sipas të ardhurave të realizuara, përsëri konstatohet se ky punonjës ka pasur një marrëdhënie pune të qëndrueshme, e cila ka zgjatur për për rreth 8 vjet, duke kryer detyrat në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Konkluzioni i grupit të mbikëqyrjes në këtë rast, në projekt raport ka qenë për të trajtuar këtë punonjës si pjesë e shërbimit civil, pasi fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur atë në pozicionin aktual, për një periudhë *mbi 1 vit*, për pasojë, ai e gëzon statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, e për këtë arsye duhet të trajtohet si i tillë nga njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore, Bashkia Tiranë.

Ndërkohë, nisur nga observacionet e subjektit të mbikëqyrur, të depozituara pranë Komisionerit me shkresën nr. 933/1 prot., datë 06.10.2015, të shoqëruara edhe me aktet administrative përkatëse, rezulton se për punonjësin *****, është bërë deklarimi i statusit të punësimit me aktin administrativ nr. 1871 prot., datë 17.07.2014, në pozicionin “*Inspektor Taksash*”, në Sektorin e Burimeve Ekonomike, në Njësinë Bashkiake nr. 11, ç`ka provon se ky punonjës e ka fituar të drejtën e tij për të qenë pjesë e shërbimit civil.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë ushtrimit të funksionit të tij të mbikëqyrjes në Njësinë Bashkiake nr. 11 Tiranë, e cila tashmë është riorganizuar si Njësi Administrative e Bashkisë Tiranë, në lidhje me monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Të gjitha rekomandimet e dhëna në këtë material duhet të zbatohen nga njësi përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, i cili është organi përgjegjës në lidhje me administrimin e mëtejshëm të shërbimit civil në këtë njësi administrative.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

- **Aneksi 1** - “*Respektimi i kërkesave të përgjithëshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.*”
- **Aneksi 2** - “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të punësuar nëpërmjet konkurrimit (data 26.02.2014).”*

- *Aneksi 3 - “Organigrama dhe historiku i marrëdhënies me shërbimin civil, të punonjësve të Njësisë Administrative (Bashkiakë) Nr. 11”.*

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA